

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE  
“COMMUNICATION & SECURITY” Sh.p.k.**

Ne Tirane sot date 18 Prill 2023 lidhet kjo kontrate:

1. BERNARD TOÇI, i biri i SULEJMANIT, lindur me 01/06/1983, ne DERJAN MAT dhe banues sot ne: Rr:”Don Bosco”, kompleksi Fior di Bosco, kulla 2, Hyrja3, Kati 5, Ap.355, kodë postar 1023 Tirane, i identifikuar me leternjofitim me nr. 036990728.

2. ARMANDO TOÇI, i biri i SULEJMANIT, lindur me 16/04/1986, ne DERJAN MAT dhe banues sot ne:Rruga Beniamin Kruta,Nd 31,Njesia Bashkiake nr.7,kodi postar 1023 Tirane, i identifikuar me leternjofitim me nr. 031393279

Të quajtur me poshte ortak (themelues) ne perputhje me Ligjin Nr. 7850, date 29.07.1994 “Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise” i ndyshuar, me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare” dhe Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombtare te Regjistrimit”

**I.FORMIMI**

I- Ortakët themelues, formojne nje shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, me mbeshtetje ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

**I.1.EMRI I SHOQERISE**

Emri i shoqerise tregtare i krijuar nga ortakët themelues ne kete akt themelimi eshte: “COMMUNICATION & SECURITY” sh.p.k.

**1.2 SELIA E SHOQERISE**


Shoqeria Tregtare COMMUNICATION & SECURITY” SH.P.K. do te jete e vendosur ne Tirane dhe selia e saj do te jete adresen Rruga “Dritan Hoxha”, Njesia nr.7, Korpusi B, me orjentim nga perendimi, dyqani ne katin perdhe Nr.7/137/ND-N11,1023.

**1.3 KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e kesaj shoqerie tregtare eshte pa afat. Me vullnetin e ortakeve kjo shoqeri mund te mbyllet ne c’do kohe dhe per c’do arsye te ligjeruar ne veprimtarine e saj.

**1.4. FILLIMI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Si dite te fillimit te veprimtarise tregtare te shoqerise do te merret data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombtare te Regjistrimit,ne zbatim te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombtare te Regjistrimit”.





## 1.5. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### **Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:**

Cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne vecanti:

Shitje paisje Elektronike-kompjuterike.Eksport-Import si dhe tregti me shumice dhe pakice te paisjeve kompjuterike,pjese te ndryshme kembimi, aksesore,servis te paisjeve kompjuterike, si dhe tregti me shumice dhe pakice te mjeteve kancelarie. Shitje pajisje kompjuterike, Eksport-Import si dhe tregti me shumice dhe pakice te pajisjeve elektronike/informatike, telekomunikacionit,sisteme vezhgimi, akses kontrolli,sisteme kunder zjarri, UPS, invertera,panele diellore, ,Sisteme Alarmi, switche, servera,Kanalina, pajisje Elektrike-Elektronike, Kabuj elektrike dhe LAN,pjese te ndryshme kembimi,aksesore, si dhe tregti me shumice dhe pakice te mjeteve kancelarike. Instalim, sherbim, mirembajtje te sistemeve kompjuterike, telekomunikacioni, sisteme vezhgimi,akses kontrolli,sisteme UPS, pajisje audio, pajisjeve muzikore, audio-vizive,materiale elektrike,sisteme telefonie,centrale telefonie, smartphone, PC-kompjutrera, monitore,etj. Eksport import dhe tregtim i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjithe periferikeve te tyre. Import eksport dhe tregtim aparaturash te te gjitha llojeve per zyra, pajisje zyrash e te tjera mjete pune kancelarike duke perfshire edhe te gjitha llojet e letres e materiale te tjera botimi, import eksport dhe tregtim printera,te konsumablave per pajisje te ndryshme, tonerave, Montim aparaturash te sipermendura, parametrizimi, konfigurim. Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te ndryshme te lidhur me internetin dhe telefonine. Importim dhe instalim pajisje elektronike monitorimi CCTV, pajisje elektronike per monitorimin e transportit rrugor, ajror, dhe detar si: radar, ANPR, kamera, etj. Importimi dhe instalim i pajisjeve elektronike te nevojshme per ndertimin e sistemeve te sigurise fizike te objekteve dhe sistemeve te sigurise publike ne aeroporte, banka, ndertesa komerciale, transport public, infrastruktura kritike, arsim, shendetesi, stadiume, qendra te kujdesit shendetesor etj. Import - eksport te mallrave me perdorim te dyfishte. Projektim,ndertim dhe mirembajtje ne fushen e rrjete WAN/LAN,Wep-site etj. Import, export, shitje me shumice dhe pakice i paisjeve pasive dhe aktive te rrjetave kompjuterike si, kabinete/rack, patch panele, kabullo bakri, fiber optike, ODF, media konvertera, multipleksera, switche, rutera, firewalle, access pointe, antena dhe te gjitha aksesoreve qe lidhen me to. Import, export, shitje me shumice dhe pakice i paisjeve per telefonine si Centrale (PBX), telefona, paisje interkoneksioni (Voice Gateways), karta analoge dhe digitale.si edhe te gjitha aksesoret qe lidhen me to. Import, export, shitje me shumice dhe pakice i paisjeve per sigurine fizike.si kamera survejimi, video rregjistrator rrjeti (NVR), enkodera/dekodera, licensa per analizues video, paisje per kontrollerin e aksesit, si edhe te gjitha aksesoret qe lidhen me to.



## II. KAPITALI BAZE

### II. 1. KAPITALI

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaku i vetem me qellim persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise, kapitali themeltar i shoqerise do te jete: 100000 (njqind mije) Lek te reja **KONTRIBUT NE NATYRE** e ndare ne dy kuota te vetme:

1. BERNARD TOÇI me 1 Kuote = (51000 Lek)
2. ARMANDO TOÇI me 1 Kuote = (49000 Lek)

## III - STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### III.1. ORGANET DREJTUSE TE SHOQERISE

Admnistratori i shoqerise do jete njëri nga themeluesit e kesaj shoqerie tregtare Shp.k. qe ne rastin konkret eshte **Z.Armando Toçi**, per nje afat 5 (pese) vjecar, nga dita e regjistrimit te shoqerise prane QKB me te drejte ripeteritje .


## IV.DISPOZITA E FUNDIT

Ky statut u hartua ne kater kopje ne gjuhen Shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore. Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, do te bazohet ligji "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodi Civil i Republikes se Shqiperise qe eshte ne fuqi.

*THEMELUESIT E SHOQERISE "COMMUNICATION & SECURITY" Sh.p.k*

### ORTAKET:

**Bernard TOÇI**



**Armando TOÇI**

